



Biografi e shkurtër

Klodjana Theodhosi, këshilltare ligjore

Klodjana Theodhosi është diplomuar me titullin “Jurist” në vitin 2002, në Fakultetin e Drejtësisë, pranë Universitetit të Tiranës. Në vitin 2013 përfundoi studimet master në “EU Business Law”, po pranë Fakultetit të Drejtësisë.

Znj.Theodhosi vjen nga një eksperiencë pune 20 vjeçare në sektorin publik. Karriera e saj profesionale zë fill në vitin 2003, si pjesë e administratës së Kuvendit të Shqipërisë, fillimisht në pozicionin e sekretares e më pas të këshilltares pranë Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Ajo ka ushtruar detyrën e këshilltares në Shërbimin Juridik të Kuvendit të Shqipërisë deri në nëntor të vitit 2017. Gjatë kësaj periudhe ka qenë pjesë e grupeve të punës për hartimin e një sërë projektligjesh të paketës ligjore së Reformës në Drejtësi. Në periudhën dhjetor 2017 – gusht 2023 ka qenë pjesë e Njësisë së Shërbimit Ligjor pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ka marrë pjesë në trajnime dhe konferenca të ndryshme brenda e jashtë vendit, me fokus teknikën llogjislative si dhe hartimin e përfrimin e legjislacionit. Zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe italiane.

Znj.Theodhosi i është bashkuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit në muajin shtator 2023.